



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org



KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 352-13874/19

Date 05.06.2019

KONTRATA PUBLIKE nr. 13-2019

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; Nr Biznesi 0700032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

dhe

G.O.E " I&B –GROUP – SHPK " NGA PRISHTINA ,& " RAHOVICA COMERCE SHPK " NGA FERIZAJ ,, Qe ne baze te mareveshjes Lider dhe bartes i kontrates eshte i caktuar " I&B –GROUP SHPK nga Prishtina , Nr. Biznesi dhe numer fiskal 810142430 , qe perfaqesohet nga i Autorizuari HALIL GJEMAJLI

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për PUNET në vijim:

NDERTIMI I KANALIZMIT NE SFERKE

me numër identifikues: 634-19-396-5-2-1/INT.634-19-004-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e PUNEVE në vijim:

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera Pa TVSH
	Vërejtje: Pozicionet në paramasë përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin e materialeve , fuqinë punëtore testimet e nevojshme , mekanizimin dhe punimin e pozicionit me të gjitha aktivitetet dhe materialet				
1.1.1	Hapja e kantierit që përfshin të gjitha objektet e nevojshme për përcjelljen e ndërtimit të objektit.	PAUSHALL	1.00	200	200.00
1.1.2	Pastrimi I terrenit përgjate trases se kanalizimit nga te gjitha pengesat si shkurret, lisat dhe te tjera	M	1457.47	0.30	437.24
1.1.3	Riincizimi i trasës. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet riincizimi i trasësë kanalizimit dhe definimin numerik të saj me të gjithë elemente e domosdoshëm (thyrjen horizontale, lichjet etj)	M	1457.47	0.25	364.37
2.1	Hapja e kanalit me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Gjatë hapjes të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në distancë të nevojshme. Nëse gjatë hapjes hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritet gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. Kategoria e tokës është V (gurore dhe shkembore). me makine 90%	M3	2018.00	2.40	4.843.20

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera Pa TVSH
2.2	Hapja e kanalit me thellësi të kanalit si në projekt dhe gjërësi mesatare 0.80m. Gjatë hapjes të kanalit menjëherë duhet shënuar dhe rrethuar kanalin në sipërfaqe, ashtu që çasja në kanal të jetë e sigurt. Gjithashtu duhet ndërtuar "ura" për kalimin e punëtorëve në distancë të nevojshme. Nëse gjatë hapjes hasim në instalim edhe objekte nëntokësore punëkryesi është i obliguar që ato t'i ruaj. Në çmim të llogaritët gërmimi, deponimi i dheut një metër larg nga kanali. Kategoria e tokës është V (gurore dhe shkembore). me dore 10%	M3	202.00	2.40	484.80
2.1.2	Sigurimi i kanalit nga shembja. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit.	M	150.00	3.00	450.00
2.1.3	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi $\pm 1\text{cm}$.	M2	1457.47	1.00	1.657.47
2.1.4	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar në deponi në vend që është caktuar nga organi mbikqyrës deri në 5km.	M3	583.00	2.00	1.166.00
2.1.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës në fundin e kanalit anash dhe mbi tub 15cm dhe ngjeshja në shtresa.	M3	583.00	8.00	4.664.00
2.1.6	Mbulimi i kanalit me materialin e germuar nga kanali në shtresa 30cm me ngjeshje adekuate.	M3	1079.00	0.50	539.50

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera Pa TVSH
2.1.7	Largimi i ujërave nëntokësore nga kanali nese paraqitet gjate gropimit me pompa.	PAUSHALL	1.00	200.00	200.00
3.1.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 PE Ø 250 - fekal SN8	M	1458.00	5.00	7.290.00
3.1.3	Vendosja e shiritit sinjalizues. Shiriti duhet të vendoset min 50cm mbi gyp. Në këtë gyp duhet të shkruhet në gjuhën shqipe "KUJDES GYP I KANALIZIMIT"	M	1458.00	1.00	1.458.00
4.1.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 d=25cm	M3	14.21	53.00	753.13
4.1.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	M3	10.66	30.00	319.80
4.1.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	29.00	30.00	870.00
4.1.4	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	COPE	29.00	18.00	522.00

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Vlera Pa TVSH
4.1.5	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø19 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	COPE	58.00	10.00	580.00
4.1.6	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej betonarme. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	COPE	29.00	8.00	232.00
4.1.7	Furnizimi, transporti, montimi dhe gypit metalik Ø300 per kalimin e rruges se asfaltuar. Në çmim te llogaritet edhe shpimi I rruges ne vendet e caktuara.	M	20.00	70.00	1.400.00
5.1.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit në joulëshueshmëri, gjithnjë sipas kushteve teknike të paraqitura për këtë lloj pune.	M	1458.00	0.50	729.00
				Vler pa tvsh	28.960.51
				TVSH 18 %	5.212.89
				Vlera me TVSH	34.173.40€

1.2. Vlera Totale e Kontratës me TVSH dhe taksa tjera eshte 34.173.40€

(Tridhjetekatermijeenejqindeshatedhjetetreeuroe40/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i perditëshëm sipas përshkrimit të detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate është **30 dite pune**.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve në SFERK

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të punëve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

3.5. Dhe atë me fature dhe Raport mbi kryerje të punëve, Jo më larg se 30 dite pas pranimit të fatures dhe Raportit.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do të ekzekutohen me keste sipas kësaj dinamike

- Kesti parë në vlerë 20.000.00 €
- Kesti dytë në vlerë 10.756.06 € pas pranimit të perkoheshëm teknik
- Kesti pestë –përfundimtarë në vlerë 3.417.34 €, pas afati të Garancionit të punimeve, perkatesisht pas 12 muajëve.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i punëve do të jetë përgjegjës për Demtimet të shkaktuara me dashje apo pa kujdesi në masën e demit që do të percaktohet nga zyrtari përgjegjës.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Në rastet e deshtimit apo vonesës në Implementim, do të penalizohet me masën 0.25% në ditë vonesa nga vlera totale e kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikojë furnizimet e bera nëse është në masën e cilesive të kërkuara.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet të jetë në formën e titullit të kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

12.2 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 13. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontrates .

13.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kerkuese –Implementuese Drejtoria Urbanizmit Komuna Kline

13.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontraes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____

13.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues
KOMUNA KLINE**

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05.04.2019
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve :

“I &B- GROUP “ & RAHOVICA “ – PRISHTINE

Emri:	HALIL XHEMAJLI
Pozita:	I AUTORIZUAR
Nënshkrimi:	
Data:	5. 4. 2019
Vula:	



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **72883**

Për **Komuna Klinë**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **"I & B - Group" SH.P.K. & "Rahovica Commerce" SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **NDERTIMI I KANALIZIMEVE. Lot 3 - KANALIZIMI SFERK**
Nr. prokurimit: 634-19-396-5-2-1, Nr. brendshëm: 634-19-004-521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **3,417.34€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **3,417.34€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë deri më 04.06.2019 ora 09:22:44

Data lëshimit: 05.04.2019.

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Nr i Serisë

0041558



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.3,
Tel: +381 (0) 38 221 112; Fax: +381 (0) 38 221 115, E-mail: office@graweelsig.com

Nr. Policës
Policy no.

72883

Gjithcka që duhet ta kenë

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË TENDERIT DHE EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS BID BOND AND PERFORMANCE BOND POLICY

Kontraktuesi:	"I & B - Group" SH.P.K. & "Rahovica Commerce" SH.P.K.		
Përfaqshues nga:	Isa Haxha		
Adresa:	K.D.Q Tregtare 48-1 Prishtinë		
Nr. i Biznesit:	810142430	Nr. i telefonit:	
Garantuesi:	Elsig		
Banka e Garantuesit:	NLB		
Përfituesi:	Komuna Klinë		
Adresa:	Klinë		
Shuma e Sigurimit	3,417.34	Numri i Marrëveshjes:	
Aktiviteti Ekonomik:	NDERTIMI I KANALIZIMEVE. Lot 3 - KANALIZIMI SFERK		
Data e fillimit	2019-04-05 00:00:00	Data e mbarimit	2019-06-04 00:00:00
Primi	58.09	TVSH	10.46
Gjithsej	68.55		
Mënyra e pageses	Ne llogari	Nr. i llogarisë	1701001011295733
Data e lëshimit	2019-04-05 09:22:44		

Lënda e garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit / Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për policia të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Nr i Serisë

0041558

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale/të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari mir vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions.

2072

Siguruesi / The Insurer



I Siguruari / The Insured